

GJYKATA KOMUNAL NE PRISHTINE

P. Nr. 2615/08

Me: 09 shtator 2009

NE EMËR TE POPULLIT

Gjykata Komunale ne Prishtine, Gjykatësi i EULEX-it Arkadiusz SEDEK, duke vepruar ne cilësinë e gjykatësit te vetëm, i ndihmuar nga procesmbajtësja Jacqueline Ryna, **ne lenden penale kundër:**

Sokol QYSE, i biri i Eshref dhe Desanka (emri i vajzërisë NIKOLIC), i lindur me 26 06.1968 ne Prizren, i martuar, babe i dy fëmijëve, me kombësi turke, i akuzuar për veprën penale te Ushtrimi i Ndikimit sipas nenit 345, paragrafi 1, te LPK si dhe për veprën penale Falsifikimi i Dokumenteve sipas nenit 332 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 te LPK-se.

Pas mbajtjes se shqyrtimeve kryesore gjyqësore publike me 23 mars, 13 maj, 01 korrik, 02 dhe 08 shtator 2009, ne praninë e te akuzuarit te përmendur këtu me larte, te avokatit tij mbrojtës Z. Zhivojin JOKANOVIQIT dhe te Prokurorit Special Z. Lulzim SYLEJMANIT;

Pas shqyrtimit te kolegjit te mbajtur me 09 shtator 2009 dhe duke u bazuar ne nenin 391 (1) te KPPK-se;

Shpalli publikisht dhe ne praninë e palëve:

AKTGJYKIMIN

I akuzuari **Sokol QYSE**, me shënimet personale siç janë përmend këtu me larte

Shpallet fajtor

Për veprat penale Ushtrimi i Ndikimit sipas nenit 345 paragrafi 1 te LPK-se dhe për veprën penale te Falsifikimit te Dokumenteve sipas nenit 332 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 te LPK-se.

Sepse

I. Ne korrik te vitit 2007, Sokol Cuse, me pjesëmarrjen e një personi te panjohur, i cili iu prezantua Yalcin AVCI-ut si C P, merr nga Yalcin AVCI shumen prej 80.000 Eurove për te konsideruar ushtrimin e një ndikimi te pavend mbi Carol PERALTA-ne, Gjykatësi

Kryesor Ndërkombëtar, dhe A C, Prokurore Kryesore Ndërkombëtare, që të dy persona zyrtar, për të mundësuar lirimin e Sedat UZ, Bilal KOTEN, Hakan YILDIRIM të cilët gjendeshin në paraburgim,

Kështu duke e kryer veprën penale të Ushtrimit të Ndikimit, sipas nenit 345, paragrafi 1 të LPK-se.

II. Me 17/07/2009, në Prishtinë, Sokol Cuse përpiloi një dokument të falsifikuar, letrën përcjellëse të A C, e cila në atë kohë ishte në cilësinë e Zëvendëse e drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut si dhe në të njëjtën kohë ishte Prokurore Kryesore Ndërkombëtare e UNMIK-ut, e cila kinse i kishte shkruar një letër Carol PERALTA-se Gjykatësit Kryesor Ndërkombëtar të UNMIK-ut, duke e furnizuar atë me informatën mbi mundësinë e shqyrtimit të lirimit me kaucion të të akuzuarve Sedat UZ, Bilal KOTEN dhe Hakan YILDIRIM të cilët në atë kohë ishin në paraburgim për veprën penale lidhur me rastin e “King Casino”-se. I akuzuari Sokol CUSE e falsifikoi dokumentin dhe ia dha këtë dokument të akuzuarit Yalcin AVCI për të bindur atë se ai ishte duke punuar me Gjykatësit dhe Prokuroret Ndërkombëtar të UNMIK-ut lidhur me mundësinë e konsiderimit të lirimit me kaucion të personave në paraburgim Sedat UZ, Bilal KOTEN dhe Hakan YILDIRIM. Po ashtu, gati në të njëjtën periudhë kohore në korrik të vitit 2007 në Prishtinë ai e përpiloi një dokument të falsifikuar, pa datë dhe numër të protokollit si një dokument formal zyrtar në emër të Z. Tome GASHI-t i cili gjatë vitit 2007 e kishte mbrojtë të akuzuarin Hakan YILDIRIM, se i njëjti avokat kinse iu kishte drejtuar Departamentit të Drejtësisë me sugjerimin se Zyra e Prokurorisë si dhe Gjykatësit të UNMIK-ut do të duhej të ishin me të kujdesshëm me rastin e marrjes së vendimit lidhur me kërkesat e avokateve tjerë, posaçërisht të atyre të të akuzuarve Sedat UZ, Bilal KOTEN dhe Hakan YILDIRIM lidhur me lirimin e tyre nga paraburgimi, meqë ekzistonte rreziku i arratisjes.

Kështu duke kryer një vepër të tillë penale të Falsifikimit të Dokumenteve sipas nenit 332 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 të LPK-se

DËNOHET

I. Sipas nenit 3 paragrafi 1(1), nenit 6, nenit 11 paragrafi 1, nenit 15 paragrafëve 1 dhe 2, nenit 34 dhe 38 paragrafëve 1 dhe 2, nenit 345 (1) dënohet me burgim prej 1 (një) viti për veprën penale të përshkruar nën pikën I,

II. Sipas nenit 3 paragrafi 1(1), nenit 6, nenit 11 paragrafi 1, neni 15 paragrafëve 1 dhe 2, neni 34 dhe 38 paragrafëve 1 dhe 2, neni 332 (1) lidhur me (3) dënohet me burgim prej 1 (një) viti dhe 6 (gjashtë) muajve për veprën penale të përshkruar nën pikën II,

III. Sipas nenit 71 paragrafët 1 dhe (2) një dënim total me burgim prej 2 (dy) vjetëve i vëhet në barrë për veprat penale të përshkruara nën pikat I dhe II.

IV. Nuk ka kërkesë pronësoro-juridike,

V. Sipas nenit 99 dhe nenit 102 të KPPK-se, i akuzuari është i obliguar t'i kompensojë shpenzimet e përgjithshme gjyqësore, të cilat janë përcaktuar në një shumë prej 100€.

ARSYETIMI

I. Historia procedurale

Ne baze te aktakuzës se ngritur nga Prokurori Ndërkombëtar Gianfranco GALLO me 27 qershor 2008 (PP. Nr.1901/-3/08), i akuzuari Sokol CUSE është akuzuar për veprën penale Ushtrimi i Ndikimit, sipas nenit 345 paragrafi 1 te LPK-se. I akuzuari tjetër Yalcin AVCI ishte ngarkuar me veprën penale Ushtrimi i Ndikimit, sipas nenit 345 paragrafi 2 te LPK-se.

Me 2 janar 2009 dosja e lendes iu është dorëzuar Gjykatësve te EULEX-it nga Departamenti i Drejtësisë se UNMIK-ut. Kryetarja e Asamblesë se Gjykatësve te EULEX-it mori vendimin me 5 janar 2009 qe rasti kundër Sokol CUSA-se dhe Yalcin AVCI-ut do te mbesin nën autoritetin e Gjykatësve te EULEX-it ne Gjykatën Komunale ne Prishtine. Vendimi është marre ne pajtim me nenin 15.2 te Ligjit mbi Juridiksionin, Ndarjes se Lendeve te Gjykatësve dhe Prokuroreve te EULEX-it ne Kosove (Ligji nr. 03/L-053).

Seancat e gjykimit kryesorë janë caktuar per 23 mars 2009, 13 maj 2009, por i akuzuari Yalcin AVCI nuk u paraqit edhe pse ishte ftuar me kohë ne gjykim. Prandaj, me 21 prill 2009 gjykata lëshoi urdhrin per arrestim kundër te akuzuarit Yalcin AVCI. Veç kësaj, me 23 qershor 2009 gjyqi vendosi te lëshoje aktvendimin mbi ndarjen e procedimeve kundër te akuzuarit Yalcin AVCI. Per seancën e caktuar me 1 korrik 2009, ishte ftuar Antonio FULCO ne cilësinë e dëshmitarit, por ai nuk erdhi në seancë duke e justifikuar mungesën e tij.

Prokurori Publik e zgjeroi propozim aktakuzën me 22 prill 2009 duke e akuzuar Sokol CUSA-ne për veprën penale te Falsifikimit te Dokumenteve sipas nenit 332, paragrafi 1 lidhur me paragrafin 3 te LPK-se.

Gjykimi kryesor filloi me 2 shtator 2009 ne një seance publike dhe është kryesuar nga një gjykatës individual te përmendur me larte. Gjykatësi Kryesor konfirmoi se ai ishte caktuar për ketë lëndë ne pajtim me ligjin. Juridiksioni i Gjykatësve te EULEX-it ne ketë lende ishte bazuar ne pajtim me nenin 3.3 p) te Ligjit mbi Juridiksionin, Ndarjes se Lendeve te Gjykatësve dhe Prokuroreve te EULEX-it ne Kosove (Ligji nr. 03/L-053). Duhet te theksohet se palët nuk kane ngrite asnjë kundërshtim lidhur me përbërjen e kolegjit. Gjate seancës se njëjte, pas leximit te aktakuzës nga ana e Prokurorit Publik, i akuzuari u pyet te deklarohet se a e ndien veten fajtor apo te pafajshëm. Si përgjigje ne këtë pyetje ai e refuzoi akuzën; ai po ashtu tha se procesi ishte politikisht i motivuar. Duke marre parasysh këtë motiv politik, i akuzuari vendosi qe te mbrohet ne heshtje. A F u dëgjua ne cilësinë e dëshmitarit ne te njëjtën seance.

Me 8 shtator 2009, provat materiale u ekspozuan dhe i akuzuari i cili e kishte pasë rastin që t'i mohojë bazat e akuzës dhe t'i thotë faktet në favor të tij refuzoi të jepte ndonjë deklaratë. Gjate seancës së njëjte u prezantuan fjalët përfundimtare të Prokurorit Publik dhe të avokatit mbrojtës . Me 09 shtator 2009, pas shqyrtimit, Gjykata e shpalli diapozitivin me shkrim të këtij aktgjykimi të përmendur më lartë.

II. Konstatimet faktike

Sokol CUSA ishte nëpunës në Divizionin e Menaxhimit të Burgjeve, përgjegjës për grumbullimin dhe sistemin e informatave të duhura dhe atëherë kur kompetencat e këtij divizioni u transferuan në IPVQ ai u bë nëpunës i Ministrisë së Drejtësisë. Për shkak të ndjeshmërisë së veçante të këtyre rasteve dhe raportit të tyre me gjykatësit ndërkombëtar, sepse i akuzuari ishte përgjegjës për lirimet me kushte në kuadër të DMB, ishte vizitues i shpeshtë në zyrën e C P-se, Gjykatësi Kryesor Ndërkombëtar. Duke u bazuar në fakte se i pandehuri Sokol Cuse në korrik 2007 ka pohuar se ai ishte në gjendje që të ushtrojë një ndikim të pavend ndaj Carol Peraltës, Kryegjykatës Ndërkombëtar, dhe A C, Kryeprokurore Ndërkombëtare, që të dy persona zyrtar, për të ardhur deri të lirimi me dorëzani i Sadat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yldirim, qytetarë turk që punonin për të njëjtën kompani si Yalcin Avci. Këta tre të pandehur në atë kohë kanë qenë në paraburgim për shkak të veprës penale të rastit të ashtuquajtur “King Casio”. Sokol Cuse, me qëllim që të ushtrojë këtë ndikim, ka kërkuar prej Avcin 80.000 euro, duke shtuar se 50.000 euro janë për C P-ën, dhe 30.000 për A C-n. Të hollat janë dhënë Sokol Cuse-s në zyrën e avokates Florie Drevinja e cila në atë kohë nuk ka qenë e pranishme në zyrë.

Përafërsisht një javë më vonë Yalcin Avci ka kuptuar se të hollat e dhëna të pandehurit Sokol Cuse nuk kanë sjell deri të lirimi i të pandehurve turq të përmendur më lartë. Kështu që ai ka kërkuar nga Sokol Cuse që të organizojë një takim me gjykatësin C P me qëllim që të përshpejtojë procedurën e lirimit të turqve. Sokol Cuse ka organizuar takimin e kërkuar, por jo me gjykatësin C P, i cili nuk ka qenë i përfshirë në këtë veprë penale fare, por me një mashkull që paraqiti veten si C P. Ky takim ka qenë i organizuar me qëllim që të mashtrohet Yalcin Avci se të hollat i janë dhënë personit të duhur i cili do të çojë deri të lirimi i këtyre të pandehurve.

Sokol Cuse gjithashtu ka ndërmarrë hapa shtesë që ta bënte Yalcin Avci-n të besonte se të hollat që ai ka dhënë do të çojnë deri të lirimi i shokëve të tij. Më 17/07/2007 në Prishtinë, Sokol Cuse ka hartuar një dokument të rrejshëm, letër përcjellëse të Annunziata Ciaravolo-s, e cila në atë kohë ka qenë në cilësinë e Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut dhe në të njëjtën kohë Kryeprokurore Ndërkombëtare e UNMIK-ut, duke pretenduar t'i ketë shkruar Udhëheqësit të Gjykatësve Ndërkombëtar të UNMIK-ut C P-s, duke i dhënë atij informatën mbi mundësinë e rishqyrtimit të lirimit me dorëzani të të pandehurve Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yilderim të cilët në atë kohë kanë qenë në paraburgim për shkak të veprës penale lidhur me rastin “King Casino”. Sokol Cuse ka falsifikuar këtë dokument dhe e ka dhënë Yalcin Avci-t me qëllim që ta bind atë se ai ishte duke punuar me Gjykatësit dhe Prokurorët

Ndërkombëtar të UNMIK-ut lidhur me mundësinë të konsiderohet lirimi me dorëzani i personave të paraburgosur Sedat uz, Bilal Koton dhe Hakan Yilderim.

Gjithashtu, gati në të njëjtën periudhë kohore në korrik 2007, në Prishtinë, ai ka hartuar një dokument tërësisht të rrejshëm pa datë dhe pa numër të protokollit si një dokument formal zyrtar në emër të avokatit T G i cili gjatë vitit 2007 ka mbrojtur të pandehurin Hakan Yilderim, se i njëjti avokat mbrojtës kinse është drejtuar Departamentit të Drejtësisë me sugjerim që Zyra e Prokurorisë si dhe Gjykatësit e UNMIK-ut duhet të jenë më të kujdesshëm kur vendosin mbi kërkesat e avokatëve tjerë mbrojtës, veçanërisht të atyre të Sedat Uz, Bilal Koton dhe Hakan Yilderim mbi lirimin e tyre nga paraburgimi, pasi që ekziston rreziku nga arratisja.

III. Vlerësimi i provave:

Faktet e vërtetuara në këtë aktgjykim bazohen në provat e prezantuara gjatë gjykimit, kryesisht mbi provat e ekzaminuara gjatë shqyrtimit kryesor, domethënë:

- 1. Memorandumi i brendshëm nga A C, dikur Kryeprokurore Ndërkombëtare, i datës 13 dhjetor 2008,
- 2. Memorandumi i datës 17 korrik 2007, tërësisht i falsifikuar kinse i përpiluar nga A C, dikur Kryeprokurore Ndërkombëtare,
- 3. Letra e avokatit Tomë Gashi, e datës 1 dhjetor 2008, e drejtuar Prokurorit të lëndës,
- 4. Memorandumi pa datë dhe numër të protokollit, plotësisht i falsifikuar dhe kinse i përpiluar nga avokat Tomë Gashi,
- 5. Memorandumi në formë të rekomandimit – kërkesës së përpiluar nga i pandehuri Sokol Cuse, pa datë dhe pa numër të protokollit, dhe kinse i pranuar më 21 qershor 2007 nga C P, ish Kryegjykatës Ndërkombëtar,
- 6. Dokumenti i përpiluar me dorëshkrim nga i pandehuri Sokol Cuse, i datës 16 gusht 2007,
- 7. Dokumenti i shkruar me dorë, i nënshkruar nga i pandehuri Sokol Cuse, pa datë, ku paraqiten numrat 30,000, 80,000, 50,000, 30,000 si dhe emrat Flora, Sokol dhe shprehjet: për C. P. (Gj) – për P.P. (Italiane)
- 8. Katër CD ku tre prej CD kanë përmbajtjen e bisedave në mes të Yalcin Avci dhe bashkëshortes së të pandehurit Sokol Cuse që janë zhvilluar më 14 gusht 2007 dhe 27 gusht 2007 me transkriptim të këtyre bisedave telefonike ku një CD ka përmbajtjen e vëzhgimit me video në vendet publike dhe në restorantin Valentino,
- 9. Një letër e drejtuar C P-s e përpiluar me shkrim me dorë më 8 gusht 2007 nga Yalcin Avci, që përmban 6 faqe,
- 10. Deklarata e C P, ish Kryegjykatës Ndërkombëtar, e datës 10 gusht 2007, që përmban 3 faqe,
- 11. Deklarata e dëshmitarit A F,
- 12. Dy raporte të oficerit të policisë A F të datës 11 dhe 17 gusht 2007,
- 13. Vendimi mbi fillimin e hetimeve i datës 27 shkurt 2008.

Deklarata e dhënë nga dëshmitari A F gjithashtu është marr në konsideratë. Duhet të theksohet se kjo deklaratë ka qenë një provë plotësuese, pasi që gjetjet faktike bazohen në dokumentet e shkruara. Trupi Gjykes nuk pa pasur dyshime mbi besueshmërinë e këtij dëshmitari dhe vërtetësinë e deklaratave të tija. Ai ka dëshmuar në mënyrë të qartë dhe objektive. Atij i kujtoheshin të gjitha detajet e rëndësishme të vëzhgimit me video dhe audio përkundër kohës së kaluar.

Për shkak të faktit se i pandehuri ka vendosur mos të përgjigjet akuzave, duke shpresuar se kjo është mbrojtja më e mirë për te, gjykata ka marr në konsideratë vetëm provat materiale që janë ekzaminuar gjatë shqyrtimit kryesor, ka vlerësuar me vetëdije çdo artikull të provës ndaras dhe në marrëdhënie me artikujt tjerë të provave dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka arritur deri te një konkluzion se i pandehuri është fajtor për kryerjen e dy veprave të përshkruara në dispozitiv.

Është fakti i pakontestueshëm se i pandehuri Sokol Cuse ka pranuar shumë prej 80.000 euro nga Yalcin Avci në korrik 2007. Dokumenti i pranuar si **prova numër 6** përmban provat kryesore lidhur me këtë. Përkundër parashtrësës së avokatit mbrojtës se të hollat e dhëna nga i pandehuri kanë qenë një lloj i huazimit, gjykata është e opinionit të ndryshëm. Pikëvështrimi i mbrojtjes është plotësisht i pabazë, jo logjik dhe në kundërshtim me provat tjera të zbuluara gjatë shqyrtimit kryesor. Ky dokument është dorëzuar Yalcin Avci-t më 16 gusht 2007 gjatë takimit në restorantin Valentino.

Është filluar nga këshillimi mbi gjetjen e arsyeve të vërteta pse i pandehuri Sokol Cuse ka marr të hollat, duhet të merret parasysh prova materiale tjetër, që është **prova numër 5** memorandumi në formë të rekomandimit – kërkesës përpiluar nga i pandehuri Sokol Cuse, pa datë ose numër të protokollit, kinse i pranuar më 21 qershor 2007 nga C P, dikur Kryegjykatës Ndërkombëtar. I pandehuri Sokol Cuse ka përgatitur këtë dokument me qëllim specifik, pasi që ai dëshironte të bindte Yalcin Avci se ai ka ndërmarrë hapat e mëtutjeshme për të liruar nga paraburgimi personat Sedat Uz, Bilal Koton dhe Hakan Yilderim. Ky konkludim logjik është nxjerr nga teksti i rekomandimit të lart përmendur në të cilin i pandehuri ka deklaruar citim: *“Për këto arsye unë kërkoj që ky rast të merret nga ju dhe personat e përmendur të lirohen në procedurën e mëtutjeshme dhe të mbrohen nga liria me dorëzani”*. Memorandumi ishte drejtuar C P-ës që tregon qartë se i pandehuri Sokol Cuse ka pranuar to hollat jo si huazim, por si një formë e të ashtuquajturës pagesë për ushtrimin e ndikimit të pavend mbi C P-ën, Kryegjykatës Ndërkombëtar, dhe A C, Kryeprokurore Ndërkombëtare, që të dy persona zyrtarë me qëllim që të arrijnë deri te lirimi me dorëzani i Sedat Uz, Bilal Koton dhe Hakan Yilderim, të cilët kanë qenë në paraburgim. Është fakt i njohur mirë se shuma aq e madhe e të hollave nuk ka qenë e huazuar në mes të personave pa arsye specifike. Pasi që i pandehuri nuk e ka bindur gjykatën se këto të holla ishin një huazim, arsye e vetme logjike është se Sokol Cuse ka pranuar një përfitim të parregullt lidhur me ushtrimin e një ndikimi të pavend.

Prova e përmendur më parë duhet të vlerësohet lidhur me provën **numër 7** dokumentin e shkruar me dorë nga i pandehuri Sokol Cuse, pa datë, ku duken numrat 30,000, 80,000, 50,000, 30,000 si dhe emrat Flora, Sokol dhe shprehjet: për C. P. (Gj)- për P. P.(Italiene). Ky dokument është dorëzuar nga i pandehuri Sokol Cuse Yalcin Avci-t, si një lloj i vërtetimit kur ky i fundit u bë i shqetësuar se Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yilderim janë ende në paraburgim përkundër faktit se të hollat janë dhënë për lirimin e tyre. Përmbajtja e këtij dokumenti është plotësisht e qartë dhe në dritën e arsytimit logjik tregon se ka qenë i përgatitur si një lloj i vërtetimit për të hollat e pranuar. Shprehjet: “50.000 për C. P. (Gj)” dhe “30.000 – për P. P. (Italiene)” tregojnë në mënyrë eksplicite se shumat e të hollave të përmendura më parë kanë qenë të dedikuara për Carol Peralta-ën Kryegjykatësin Ndërkombëtar – 50.000 C. P. (Gj) dhe A C-n Kryeprokurore Ndërkombëtare – 30.000 – për P. P. (Italiene). Zakonisht dihet se shkurtesa P. P. qëndron për Prokuroren Publike dhe A C është e nacionalitetit italian që ka përdorur gjatë kryerjes së funksionit të Prokurores Publike në Kosovë në atë kohë. Sikur që u shpjegua më lartë kjo provë dokumentuese është një element i rëndësishëm në procesin e vërtetimit të gjetjeve faktike në këtë rast dhe të dëshmimit të fajësisë së të pandehurit.

Një provë tjetër e rëndësishme në këtë rast është letra e shkruar me dorë nga Yalcin Avci e përpiluar më 8.08.2007 e drejtuar gjykatësit C P **prova numër 9**. Nuk ka arsye të dyshohet në besueshmërinë e deklaratës së dhënë nga Yalcin Avci në këtë letër. Yalcin Avci ka shkruar një letër C P-ës, Kryegjykatësit Ndërkombëtar, duke e kërkuar drejtësinë i pashpresë kur ka kuptuar se Yalcin Avci nuk kishte kapacitet për të arritur deri te lirimi me dorëzani i Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yilderim, kështu që Yalcin Avci nuk kishte arsye të fshehtë nga ai faktet e vërteta. Kjo deklaratë zyrtare e shkruar dhe e nënshkruar nga Yalcin Avci është e qartë, precize dhe logjike. Yalcin Avci ka prezantuar të gjitha rrethanat e marrëdhënies me Sokol Cusen edhe pse këto ngjarje e kanë futur atë në pozitë të pafavorshme dhe në fund e kanë venë atë të hapur ndaj akuzës penale. Gjithashtu duhet të theksohet se, megjithëse Yalcin Avci edhe u ngarkua me vepër penale, kjo nuk do të thotë se kredibiliteti i kësaj deklaratë mund të nënçmohet, pasi që gjykata ka qenë në posedim të provave tjera që kanë lejuar që të vërtetohet përtej çfarëdo dyshimi se Sokol Cuse ka pranuar të hollat jo si një huazim, por si një pagesë për lirim të pretenduar të tre qytetarëve turk të cilët kanë qenë në paraburgim.

Kjo provë është gjithashtu veçanërisht esenciale, pasi që lejon një konkluzion mbi motivet për falsifikimin e dokumenteve të përshkruara në dispozitiv. Është e qartë se Yalcin Avci duke e paguar një shumë të tillë të parave dhe pasi që nuk ka parë rezultatin e pritur, ka filluar të bënte presion mbi Sokol Cuisen që të përshpejtojë lirimin e Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yilderim. Është e dukshme se Sokol Cuse ka dashur të mashtrtojë Yalcin Avci se ai ka bërë krejt çka është e mundur për të siguruar lirimin e të përmendurve më parë.

Kjo ishte arsye pse ai ka përgatitur memorandumimin e datës 17 korrik 2007, plotësisht të falsifikuar me pretendim se është hartuar nga A C, dikur Kryeprokurore Ndërkombëtare – **prova numër 2** dhe e ka dorëzuar Yalcin Avci-t. Ai ka rritë shpresat Yalcin Avci-t me fjalët vijuese: “Aktualisht ne jemi duke vendosur mbi shumën e dorëzansisë për lirim. Ne

kemi baza për këtë vendim, vetëm jemi duke pritur rekomandimin nga prokurori ndërkombëtar i cili merret me këtë rast” Sipas intrigës së bërë nga i pandehuri pengesa e madhe në rrugë për lirimin e Sedat Uz, Bilal Koton dhe Hakan Yldirim ka qenë avokati i tyre mbrojtës i dikurshëm Tomë Gashi: *“Ju lutem të jeni të informuar se ne kemi presion të madh nga avokati i dikurshëm i kësaj lënde Z. Tomë Gashi. Ai më nuk është avokat i këtij rasti, por po bën presion në ish prokurorët vendor që kanë qenë (përgjegjës) për këtë rast. Duke marr në konsideratë seriozitetin e këtij rasti unë ju informoj se ne do të ndërmarrim masat e nevojshme për të zgjedhur këtë problem”*.

Ekziston prova objektive që vërteton përtej çfarëdo dyshimi se i pandehuri ka falsifikuar këtë dokument (prova nr. 2). A C, ish Kryeprokurore Ndërkombëtare, në një memorandum ndër zyrtar të datës 13 dhjetor 2008 – **prova numër 1** ka informuar prokurorin e përgjegjës mbi këtë hetim lidhur me falsifikimin e memorandumit të përmendur më parë. A C ka shpjeguar në mënyrë bindëse se nënshkrimi që paraqitet pranë emrit të saj nuk është i saj pasi që mund të vërehet lehtë me krahasimin e atij nënshkrimi me nënshkrimin në memorandumin e brendshëm. E dyta, ajo ka përmendur se dokumenti i falsifikuar ka qenë me plotë gabime gramatike dhe gabime në të shkruarit dhe bile emri i saj ka qenë i shkruar gabimisht. Për më tepër, përpos përmbajtjes së rrejshme, dokumenti ka pasur gabime formale dhe nuk ka pasur elementet formale që kërkohen sipas Udhëzimit mbi Korrespondencë të Kombeve të Bashkuara. Në fund, dokumenti i falsifikuar nuk ka pasur një numër të referencës dhe nuk është paraqitur në librin e daljes të Divizionit Penal. Duke e kontrolluar dokumentin e falsifikuar lidhur me memorandumin e brendshëm të A C-s, gjykata e ndan të njëjtin vështrim dhe gjen se nuk ka baza të dyshohet lidhur me besueshmërinë e deklaratës së saj.

Një dokument tjetër që ka qenë i falsifikuar nga i pandehuri është memorandumimi pa datë dhe numër të protokollit, duke pretenduar të jetë i hartuar nga avokati Tomë Gashi – **prova numër 4**. Mendimi i kësaj gjykate është se ky dokument gjithashtu është plotësisht i falsifikuar dhe i pandehuri ka pasur motivin e fortë për ta përgatitur. Nga dosja është e njohur se T G ka qenë avokat i Hakan Yldirim, por ai ka qenë i shkarkuar kur i pandehuri i ka ofruar shërbimin e tij. Sokol Cuse ka falsifikuar këtë memorandum me një qëllim të qartë. Ai dëshironte të shkaktonte armiqësi në mes të Yalcin Avci dhe Tomë Gashit, pasi që ai frikësohej se Tomë Gashi do të zbulonte veprimet e tija penale.

Pas krahasimit të memorandumit të falsifikuar me një letër të avokatit, të datës 1 dhjetor 2008 – **prova numër 3**, dhe të adresuar prokurorit të lëndës, është e dukshme se dokumenti i parë i përmendur ka qenë tërësisht i falsifikuar. Një titull i provës nr. 3 demonstroi se T G ka zyrën e tij të avokatit në rrugën Luan Haradinaj 15 dhe kjo çështje nuk ngrit dyshime, në ndërkohë i pandehuri nuk ka qenë në dijeni mbi këtë fakt dhe e ka vendosur zyrën e Tomë Gashit në rrugën Nënë Terezë. Për më tepër Tomë Gashi në korrespondencën e tij përdor një logo special (shiko titullin e provës nr. 3). Dokumenti i falsifikuar (prova nr. 4) nuk e ka një të tillë.

Gjykata gjithashtu nuk ka dyshime lidhur me vërtetësinë e deklaratës së C P-ës, ish Kryegjykatësit Ndërkombëtar, të datës 10 gusht 2007 **prova numër 10**. C P ka shpjeguar në hollësi të gjitha rrethanat e takimit me T G dhe Yalcin Avci që kanë ndodhur të

mërkurën më 8 gusht 2008. Deklarata e tij është e sinqertë, logjike dhe objektive, pasi që ai ka pranuar se Sokol Cuse si një i punësuar i Divizionit të Menaxhimit të Burgut përgjegjës për Lirim me Kusht ka qenë një vizitor i shpeshtë në zyre të tij gjatë kryerjes së detyrave të tija ditore. Në këtë deklaratë C P gjithashtu ka treguar se Yalcin Avci iu është afruar dhe i ka thënë se axha/daja i bashkëshortes së tij është arrestuar së bashku me dy meshkuj tjerë të kombit turk dhe ka shprehur shqetësimet e tija se ata nuk do të trajtohen si duhet nga gjykatat vendore. Yalcin Avci ka kërkuar nga C P nëse ai do të merr në konsideratë që të merr rastin. Si përgjigje ndaj sugjerimit të tij C P i ka sugjeruar Yacin Avci që të përgatitë një parashtrësë me shkrim që pastaj do të konsiderohet nëpërmes të kanaleve të rregullta dhe do të merret vendimi.

Është e rëndësishme të theksohet, se C P as nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që çon deri te lirimi nga paraburgimi me dorëzani i Sedat Uz, Bilal Koten, Hakan Yldirim, as nuk ka pranuar kurrfarë të hollash nga Sokol Çuse.

Nuk ka dyshime as lidhur me besueshmërinë e këtij dokumenti, pasi që ka qenë i përpiluar nga profesionisti i nivelit të lartë që gëzon reputacion të panjollësor.

Provat tjera që duhet të vlerësohen janë një transkriptim i bisedave telefonike të zhvilluara më 14 gusht 20 dhe 28 gusht 2007 **provat numër 8 dhe 12**. Pas ekzaminimit të këtyre dokumenteve është gjetur se të hollat janë dhënë por jo si një huazim por si një pagesë për punët jologjore. Yalcin Avci ka insistuar me këmbëngulje kthimin e të hollave nga bashkëshortja e Sokol Cuses, pasi që ai ka qenë i ndier i mashtruar nga Sokol Cuse i cili i ka premtuar atij se Sedat Uz, Bilal Koten, Hakan Yldirim do të lirohen me dorëzani nga paraburgimi. Raportet policore të shkruara nga A F tregojnë rrethanat e veprimeve policore të ndërmarra gjatë mbledhjes së provave në restorantin Valentino.

Të gjitha provat vërtetojnë tërësisht njëra tjetrën dhe mbështesin logjikën dhe qartë vërtetojnë se Sokol Cuse ka marrë 80.000 euro nga Yalcin Avci lidhur me përpjekjen për një ndikim të pavend mbi C P dhe A C, që të dy persona zyrtarë, me qëllim që të arrihet deri te lirimi i Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yldirim të cilët kanë qenë në paraburgim. Opsioni tjetër i paraqitur nga avokatët mbrojtës është plotësisht i pabazë dhe duhet të konsiderohet si të jetë i përgatitur vetëm për qëllimin e këtij gjykimi.

Dokumentet e përmendura në dispozitiv gjithashtu kanë qenë të falsifikuara nga i pandehuri qëllimi i të cilëve ka qenë të sigurojë përsëri Yalcin Avci-n se ai ka ndërmarrë veprimet për të arritur lirimin me dorëzani, por ka qenë i përballur me pengesa.

IV. Vlerësimi ligjor:

Pas shikimit të provave të përmendura më lartë dhe ekzaminimit të dëshmitarit gjatë procedurës gjyqësore, Gjykata ka gjetur se Sokol Cuse është fajtor përtej dyshimit të arsyeshëm për veprat penale për të cilat ngarkohet në aktakuzë dhe në aktakuzën e ndryshuar.

Është e qartë se i pandehuri ka kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit, në bazë të nenit 345, paragrafit 1 të KPK pasi që në korrik 2007, në Prishtinë, Sokol Cuse, në

bashkëkryerje me një person të panjohur, i cili ka prezantuar veten te Yalcin Avci si Carol Peralta, ka pranuar nga Ylacin Avci 80.000 euro lidhur me një ndikim të pavend mbi C P-ën, Kryegjykatësin Ndërkombëtar, dhe A C, Kryeprokurore Ndërkombëtare, që të dy persona zyrtarë, me qëllim të arrijë deri te lirimi me dorëzani i Sedat Uz, Hakan Ylderim dhe Bilal Koten, të cilët kanë qenë në paraburgim.

Nuk është relevante nëse ndikimi i supozuar është ushtruar apo jo ose, a është arritur apo jo rezultati i tentuar, për të gjetur kryesin e veprës fajtor për kryerje të këtij krimi. Lidhja e ushtrimit të ndikimit mbi një personi zyrtar vendim-marrës duhet të vërtetohet. Neni 107, paragrafi 1 i KPK, thotë: “Termi personi zyrtar nënkupton (...) 3) një person që ushtron detyra specifike zyrtare, në bazë të autorizimit me ligj, 4) personi që është anëtar i personelit të UNMIK-ut ose KFOR-it, pa paragjykim ndaj privilegjeve të aplikueshme dhe imuniteteve të akorduara ndaj një personi të tillë”. Ndërsa neni 107, paragrafi 14 i KPK, thotë: “termi personel i UNMIK-ut nënkupton zyrtarët e Kombeve të Bashkuara, ekspertët dhe personat tjerë të caktuar të shërbejnë në cilëndo komponent të UNMIK-ut dhe bartës i një karte ID, që tregon se mbajtësi është një anëtar i UNMIK-ut, lëshuar me ose ndër autoritetin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm”.

Lidhur me dispozitën e cituar, që të dy, Carol Perlta duke qenë Kryegjykatës Ndërkombëtar dhe Annunciata Ciaravolo duke qenë Kryeprokurore Ndërkombëtare kanë qenë persona zyrtar në kohën kur krimi ishte kryer.

Sikur që u deklarua në raport shpjegues në Konventën e Ligjit Penal mbi Korrupsion të Këshillit të Evropës (paragrafi 64): “ Se ushtrimi i ndikimit për të qenë krim kërkohet që të prekë rrethin e ngushtë të zyrtarit ose të partisë politike të cilës ai i takon dhe të nxitë sjellje korruptuese të këtyre personave që janë në afërsi të pushtetit dhe tentojë të përfitojë nga gjendja e tyre, duke i kontribuar atmosferës së korrupsionit”.

Përpos kësaj, i pandehuri ka kryer një vepër të falsifikimit të dokumenteve në bazë të nenit 332, paragrafit 1 lidhur me paragrafin 3 të KPK, pasi që: Më 17/07/2007, në Prishtinë, Sokol Cuse ka përpiluar një dokument të rrejshëm, letrën përcjellëse të A C-s, e cila në atë kohë ka qenë në cilësinë e Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut dhe në të njëjtën kohë Kryeprokurore Ndërkombëtare e UNMIK-ut, duke pretenduar se ajo i shkruante Kryegjykatësit Ndërkombëtar të UNMIK-ut C P, duke i ofruar informata lidhur me mundësinë e rishqyrtimit të lirimimit me dorëzani të pandehurve Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Ylderim të cilët në atë kohë kanë qenë në paraburgim për shkak të veprës penale lidhur me rastin “King Casino”. I pandehuri Sokol Cuse ka falsifikuar një dokument dhe e ka dhënë këtë dokument të pandehurit Yalcin Avci me qëllim që ta bind se ai ka punuar me Gjykatësit dhe Prokurorët Ndërkombëtar të UNMIK-ut mbi mundësinë që të konsiderojnë lirimin me dorëzani të personave të paraburgosur Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Ylderim. Gjithashtu, gati në të njëjtën periudhë kohore në korrik 2007 në Prishtinë ai ka përpiluar një dokument tërësisht të rrejshëm pa datë dhe pa numër të protokollit si një dokument formal zyrtar në emër të avokatit Tomë Gashit i cili gjatë vitit 2007 ka mbrojtur të pandehurin Hakan Ylderim, se i njëjti avokat mbrojtës kinse iu drejtonte Departamentit të Drejtësisë me sugjerim që Zyra e Prokurorisë dhe gjithashtu gjykatësit e UNMIK-ut duhet të jenë më të

kujdesshëm gjatë vendosjes lidhur me kërkesat e avokatëve tjerë mbrojtës, veçanërisht atyre të të pandehurve Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yldirim mbi lirimin e tyre nga paraburgimi, pasi që ekziston rreziku nga arratisja.

Neni 107, paragrafi 6 i KPK, thotë se termi “dokument” domethënë cilido objekt i përshtatshëm ose i dizajnuar që të shërbejë si provë mbi disa fakte relevante të marrëdhënieve ligjore. Që të dy dokumente të përmendura në pikën 2 të dispozitivit bien nën fushën e definicioneve ligjore të termit dokument.

Duke vendosur mbi dënimin e Sokol Cuses, gjykata është mbështetur në dispozitën e nenit 345 paragrafit 1 të KPK, që parashikon një dënim me burg deri në 2 vjet. Në rastin e veprës penale të dytë, neni 332, paragrafi 1 dhe 3 të KPK parashikon burgimin deri në 3 vjet. Sipas nenit 38 (1) dhe (2) të KPK dënimi me burg nuk mund të jetë më i shkurtër se pesëmbëdhjetë ditë. Dënimi me burg caktohet me vite të plota dhe me muaj, dhe në rastet kur kohëzgjatja është deri në gjashtë muaj, në ditë të plota.

Në bazë të nenit 64(1) të KPK kur gjykata bien gjykimin duhet të merr në konsideratë qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat relevante lehtësuese dhe rënduese ndaj dënimit veçanërisht shkallën e përgjegjësisë penale, motivet e kryerjes së veprës, intensiteti i rrezikut ndaj vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat vepra është kryer, sjelljen e kaluar të kryesit, rrethanat personale dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në përpjesëtim me peshën e veprës dhe sjelljen dhe rrethanat e kryesit të veprës.

1. Si rrethana lehtësuese:

- Është i martuar, ka familje

2. Si rrethana rënduese:

- Intensiteti i lartë i rrezikut ndaj vlerave të mbrojtura, që domethënë: rendit publik në rastin e veprës së falsifikimit të dokumenteve dhe detyrës zyrtare me rastin e veprës penale të ushtrimit të ndikimit,
- Shuma e lartë e të hollave të pranuar
- Ai ende nuk i ka kthyer të hollat
- Fakti se ai jo vetëm që e ekspozoi C P duke qenë Kryegjykatës Ndërkombëtar dhe A C duke qenë Kryeprokurore Ndërkombëtare ndaj rrezikut të shkatërrimit të reputacionit të tyre të lartë, por ai gjithashtu ka dobësuar autoritetin e sistemit gjyqësor në Kosovën pas konfliktit.

Duke i marr të gjitha këto rrethana në konsideratë të kujdesshme kjo gjykatë ka gjetur se burgimi: prej një viti lidhur me pikën e parë, dhe një vjet e gjashtë muaj lidhur me pikën e dytë do të kishte me qenë me vend dhe e nevojshme që të plotësojë të gjitha qëllimet e dënimit të përmendura në nenin 64(1) të KPK. Sipas nenit 71 (1) dhe 2(2) të KPK, gjykata ka qenë e obliguar që të caktojë një dënim unik për të gjitha veprat penale, pasi që i pandehuri ka kryer dy vepra penale për të cilat ai ka qenë i gjykuar në të njëjtën kohë. Kur ka vendosur mbi dënimin unik, gjykata gjithashtu ka marr në konsideratë dispozitën vijuese: “Nëse gjykata ka shpallur një dënim të burgimit për çdo vepër penale,

dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim individual por dënimi unik nuk mund të jetë aq i lartë pasi që shuma e të gjitha dënimeve të caktuara nuk mund të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetëve.

Gjykata ka qenë e mendimit se dënimi unik prej dy viteve kishte me qenë me vend dhe i nevojshëm për të plotësuar të gjitha qëllimet e dënimit të përmendur në nenin 64(1) të KPK.

Kjo gjykatë ka vendosur se kushtet për të shpallur një dënim me kusht nuk janë marr parasysh, pasi që i pandehuri është person i pa skrupull i angazhuar në veprime joligjore, pasi që ai ka vendosur që të përdorë një njohësi të tij profesionale (bashkëpunëtor) me njerëz në pozita të larta në sistemin e drejtësisë të Kosovës dhe dijeninë dhe përvojën e tij me këtë sistem, me qëllim që të ketë përfitime personale. Duhet të theksohet fort se shuma prej 80.000 eurove është një shumë e madhe, duke marr në konsideratë gjendjen ekonomike në Kosovë, dhe i pandehuri as nuk ka ndërmarrë asnjë hap me qëllim që t'i kthej të hollat. Sokol Cuse ka qenë as tepër i sigurt në vetvete dhe i bindur se ai do të merr të hollat me sukses sa që ka krijuar një rrjetë të intrigave për të bindur Ylacin Avci se Sedat Uz, Bilal Koten dhe Hakan Yildirim do të lirohen me dorëzani. Me këtë synim ai ka falsifikuar dy dokumente zyrtare dhe bile ka kërkuar nga një person që të pretendoj se ishte Carol Peralta gjatë takimit me Yalcin Avci. Gjithashtu nuk duhet të harrohet se pasi që ai ka pranuar të hollat, ai ka vazhduar me premtimet ndaj Yalcin Avci, se ai do të kthej të hollat.

Duke marr në konsideratë rrethanat e përmendura më lartë gjykata ka qenë e opinionit se kryesi nuk ka merituar që të trajtohet më butë duke i ofruar një privilegje të dënimit me kusht. Ky lloj i sjelljes sikur që e ka treguar i pandehuri duhet të dënohet ashpër. Në këtë rast vetëm dënimi me burgim pa kusht do të garantojë që qëllimi i dënimit kundër kryesit të veprës do të arrihet, dhe veçanërisht se ai nuk do të përsëritë veprën. Ky dënim do të bind të pandehurin se ligji duhet të respektohet.

Duhet të vërehet se gjatë shqyrtimit kryesor asnjë palë e dëmtuar nuk ka dalë dhe kërkesa pronësore juridike nuk është paraqitur.

V. Çmimi i procedurës penale

I pandehuri duhet të mbajë shpenzimet e procedurës penale në bazë të nenit 99 dhe 102 të KPK. Shuma prej 100 eurove do të paguhet si një paushall.

Procesmbajtësja
Jacqueline Ryan

Kryetari i Trupit Gjykses
Arkadiusz Sedek

Këshilla ligjore

Në bazë të nenit 400 (1) të KPPK, ankesa mund të paralajmërohet brenda 8 ditëve nga shpallja e këtij aktgjykimi dhe sipas nenit 398(1) KPK, ankesa duhet të dorëzohet kësaj Gjykate brenda 15 ditëve nga data kur kopja e këtij aktgjykimi është dorëzuar palëve.